

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA THEMELORE NË FERIZAJ, Departamenti i Përgjithshëm, Divizioni Penal, në përbërje nga gjyqtari individual Mustaf Tahiri, me pjesëmarrjen e sek. juridike, Albana Ajvazi, në çështjen penale kundër të akuzuarit A.F. nga Ferizaj, për shkak të veprës penale detyrimi nga neni 267 par. 1 të KPK-së, sipas aktakuzës së PPK-së në Ferizaj PP.nr.1620/2010 të dt.18.05.2011 dhe veprës penale lëndim i lehtë trupor nga neni 188 par.1 i KPRK-së sipas aktakuzës së PTH-së në Ferizaj PP.nr.2022-4/13 të dt.14.04.2014, pas mbajtjes së shqyrtimit gjyqësor publik, në praninë e përfaqësuesit të akuzës prokurorit të shtetit Visar Musa, të dëmtuarës V.SH. dhe të akuzuarit, më dt.09.08.2016 të njëjtën ditë mori dhe publikisht shpall këtë:

A K T G J Y K I M

I pandehuri, **A.F.U** nga Ferizaj, rr.”.....”, kati ..., nr..., hyrja ..., data e lindjes....., në fsh....., komuna Ferizaj, nga i ati A. dhe e ëma A., e gjinisë A., ka të kryer shkollën fillore, i martuar, punëtor fizik, i gjendjes së mesme ekonomike, shqiptar, shtetas i Republikës së Kosovës, me nr.persl.....

ËSHTË FAJTOR

1. Sepse me datë 11.11.2010, rreth orës 14.00, në Ferizaj, në rrugën “Gursel dhe Bajram Sylejmani”, saktësisht në banesën e të dëmtuarës V.SH., me qëllim që vetes apo personit tjetër t'i sjell përfitim pasuror të kundërligjshëm, ka detyruar të dëmtuarën që të veprojë në dëm të pasurisë së saj, duke iu kanosur seriozisht se do ta vrasë, me ç'rast i ka kërkuar shumën prej 500€, ku e njëjta nga frika se do t'i ndodhë diçka e keqe ka qenë e detyruar që t'ia jap shumën prej 500€,

Me të këtë kreu veprën penale detyrimi nga neni 267 par.1 të KPK-së.

2. Sepse me datë 24.09.2013 rreth orës 21.00 në ëmbëltoren “.....” në Ferizaj, pas një mosmarrëveshje me të dëmtuarën V.SH. i cili kishte kërkuar të holla nga ajo por ajo nuk ia kishte dhënë, ku e kishte kapur për fyti dhe e kishte goditur me grusht në hundë duke i shkaktuar lëndime të lehta trupore dhe atë ndrydhje (mbretje) e indeve të buta të regjionit muror të kokës dhe shuplakës së dorës, e të cilat lëndime rezultojnë me pasoja të përkohshme për shëndetin,

Me të cilën kreu veprën penale lëndim i lehtë trupor nga neni 188 par.1 i KPRK-së

Andaj Gjykata në bazë të nenit të lartcekur dhe neneve 3, 6, 11, 15, 34, 36, 39 dhe 64 të KPK-së, dhe nen 365 të KPPK-së, të pandehurin e,

G J Y K O N

- 1. Për veprën penale sipas pikës I të këtij aktgjykimi DËNIM BURGIMI në kohëzgjatje prej 3 (tre) muaj, i cili dënim do të ekzekutohet 15 ditë pas plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi.**

- 2. Për veprën penale sipas pikës II të këtij aktgjykimi i shqipton DËNIM ME GJOBË në lartësi prej 200 € (dy qind euro), i cili dënim do të ekzekutohet 15 ditë pas plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi.**

Nëse dënimi i shqiptuar me gjobë nuk mund të ekzekutohet as në mënyra të tjera të parapara në nen. 46 të KPRK-së, do të ekzekutohet në atë mënyrë që për çdo 20 (njëzet) € i pandehuri do të vuaj një ditë burgu.

E dëmtuara V.SH., për realizimin e kërkesës pasurore Juridike udhëzohet në kontest civil

Obligohet i pandehuri që në emër të shpenzimeve të procedurës penale të paguaj shumën prej 20€ si dhe në emër të paushallit gjyqësor shumën prej 30 €, në afat prej 30 ditëve, nga dita e plotfuqishmërisë së aktgjykimit nën kërcënimin e përmbartimit me dhunë.

A r s y e t i m i

PPK në Ferizaj të akuzuarin A.F. nga Ferizaj,e ka akuzuar për shkak të veprës penale detyrimi nga neni 267 par. 1 të KPK-së, sipas aktakuzës së PPK-së në Ferizaj PP.nr.1620/2010 të dt.18.05.2010 dhe veprës penale lëndim i lehtë trupor nga neni 188 par.1 i KPRK-së sipas aktakuzës së PTH-së në Ferizaj PP.nr.2022-4/13 të dt.14.04.2014.

Gjykata me aktvendimin P.nr.216/13 të dt.09.08.2016 konform nenit 35 par.7 të KPP-së ka bashkuar procedurën penale sipas lëndëve P.nr.216/13 dhe P.nr.405/14, sipas aktakuzës së PPK-së në Ferizaj PP.nr.1620/2010 të datës 18.05.2011 për shkak të veprës penale detyrimi nga neni 267 par.1 të KPK-së dhe sipas aktakuzës së PTH-së në Ferizaj PP.nr.2022-4/13 të datës 14.04.2014 për shkak të veprës penale lëndim i lehtë trupor nga neni 188 par.1 të KPRK-së dhe sipas këtyre çështjeve të zbatohet një procedurë e bashkuar e cila do të udhëhiqet me numër të lëndës P.nr.216/16 dhe do të mirret një aktgjykim.

Gjykata duke vepruar në këtë çështje penale me date 09.08.2016 mbajti shqyrtimin gjyqësor, në të cilën përfaqësuesi i akuzës – prokurori i shtetit Visar Musa fillimisht lexoi aktin akuzues dhe më pas në fjalën e tij përfundimtare ka mbet në tërësi pranë akuzave dhe kualifikimeve juridike të saj, njëherit ka kërkuar nga gjykata të njëjtin ta shpall fajtor dhe ti shqiptoj dënim të paraparë me ligj.

Gjyqtari individual pasi u bind se i pandehuri ka kuptuar akuzën, konform nenit 325 të KPPK-së të akuzuarit i ofroi mundësin të pranoj fajësinë ose të deklarohet i pafajshëm.

I pandehuri A.F. në shqyrtimin gjyqësor është deklaruar i pa fajshëm për veprat penale me të cilën është ngarkuar duke deklaruar se me të dëmtuarën V.SH. kemi bashkëjetuar dhe atë që nga viti 2007/2008 dhe deri në vitin 2014 dhe se gjatë kësaj periudhe herë pas here raportet kanë qenë jo të mira dhe atë për shkak të xhelozisë, për shkak të V.SH. unë disa here kam qenë i akuzuar dhe i dënuar deri sa vitin 2014 i kam shkëputur përfundimisht raportet me të dëmtuarën. Ndërsa sa i përket veprës penale detyrimi nga neni 267 par.1 të KPK-së, se data 11.11.2010 për të cilën akuzohet se i ka kërkuar 500€ nga e dëmtuara nuk i kujtohet dhe se as që e ka detyruar ndonjëherë që të me jep para, i njëjti ka deklaruar se ka qenë në ndalim prej 48 orësh mirëpo nuk e di se për cilin rast dhe se jam liruar ku më ka parë e dëmtuara e cila menjëherë e ka telefonuar prokurorin e i cili me ka thirrur prape. Ndërsa sa i përket veprës penale lëndim i lehtë trupor, i akuzuari ka deklaruar se i kujtohet data 24.09.2013 e di se kam shkuar në ëmbëltores "....." pasi që shpesh kam qëndruar aty dhe nuk është e vërtetë që e kam sulmuar të dëmtuarën e as që i kam shkaktuar lëndime, por e di se kemi pasur një mosmarrëveshje mes vete lidhur me një telefon dhe as që e kam goditur e as nuk i kam kërkuar para.

Gjykata pas administrimit të provave në shqyrtim gjyqësor dhe vlerësimit të tyre një nga një dhe në lidhje me provat e tjera, ku në bazë të këtij vlerësimi vërtetohet gjendjen e fakteve si në dispozitivet të këtij aktgjykimi.

Gjendjen faktike gjykata e vërtetoi nga dëshmia e dëshmitarit-të dëmtuarës V.SH., e cila në shqyrtimin gjyqësor ka deklaruar se sa i përket veprës penale detyrimi nga neni 267 par.1 të KPK-së, e njëjta ka deklaruar se gjatë periudhës kohore në vitin 2010 me të akuzuarin A.F. kanë bashkëjetuar dhe se e ka pasur të dashur. Sa i përket datës 11.11.2010, i akuzuari atë ditë ka qenë i ndaluar në Prokurori për një vepër penale tjetër të shkaktuar ndaj meje dhe se i njëjti ka ardhur në banesë time duke më detyruar që t'ia gjejë 500€ në afat prej 3-4 ditësh, që t'ia paguaj detyrimet ndaj avokatit Y.H. dhe brenda këtij afati unë jam detyruar që t'ia gjejë 500€, ku unë duke qenë e detyruar dhe e kërcënuar nga i akuzuari duke më goditur dhe duke ma kërcënuar familjen duke aluduar në vajzën e motrës dhe djalin e motrës, unë ia kam dhënë paratë të cilat para i kam marrë nga motra ime. Ndërsa sa i përket veprës penale lëndim i lehtë trupor nga neni 188 par.1 të KPK-së, sipas aktakuzës PP.nr.2022-4/13 të dt.14.04.2013 e dëmtuara V.SH. ka deklaruar se i kujtohet data 24.09.2013 rreth orës 21.00 derisa e kishte lëshuar punën në Kafë ".....", ku ishte duke punuar dhe ka shkuar në ëmbëltores "....." për të pirë kafë, aty kishte ardhur i akuzuari A.F. dhe është ulur tek ajo, pasi që paraprakisht kishin mosmarrëveshje pasi që i njëjti i kishte kërkuar të holla në shumën prej 150€ dhe e dëmtuara kishte insistuar që të mos ja jep dhe se gjatë bisedës ishte munduar ta qetësoj gjendjen duke i thënë se nuk kishte para për ti dhënë, dhe se pas kësaj kishte shkuar në tualet në mënyrë që nga aty ta lajmëroj policinë, i akuzuari kishte shkuar në tualet dhe e kishte goditur në pjesë të ndryshme të trupit duke ia marrë paratë dhe telefonin derisa punëtorja e ëmbëltores ka ndërhyrë dhe e ka ndal të akuzuarin i cili pastaj ishte larguar nga aty, dhe pasi që kishin lajmëruar policinë e cila ka ardhur dhe të njëjtën e kishin dërguar në Qendrën Emergjente në Ferizaj.

Gjykata dëshminë e të dëmtuarës V.SH. e vlerësoi si të besueshme, pasi që e njëjta është objektive dhe identike edhe me deklaratat e mëhershme të dëmtuarës të dhëna në procedurën hetimore dhe e njëjta mbështet edhe në prova dhe fakte të cilat janë

administruar në cilësinë e provës siç është mendimi dhe konstatimi i ekspertit të mjekësisë ligjore i datës 21.03.2014 si dhe në dokumentacionin tjetër që gjendet në shkresat e lëndës.

Mbrojtja e të pandehurit se nuk e ka kryer veprat penale është pabazuar nuk ka mbështetje në prova dhe fakte, dhe si e tillë më shumë e orientuar në drejtim të justifikimit të veprimeve të tij inkriminuese, me qëllim të shmangies nga përgjegjësia penale dhe është shumë e qartë se i pandehuri dëshiron t'i shmanget përgjegjësisë penale. Pra gjykata në bazë të gjitha provave materiale të rastit dhe në bazë të deklarimeve të dëmtuarës ka vërtetuar gjendja e fakteve si në dispozitivet e këtij aktgjykimi, dhe se vlerësuar nga aspekti juridik gjykata gjeti se në veprimet e të akuzuarit manifestohen të gjitha elementet objektive dhe subjektive të veprës penale detyrimi nga neni 267 par. 1 të KPK-së si në pikën I të këtij aktgjykimi, ku i pandehuri me datë 11.11.2010, rreth orës 14.00, në Ferizaj, në rrugën "Gursel dhe Bajram Sylejmani", saktësisht në banesën e të dëmtuarës V.SH., me qëllim që vetes apo personit tjetër t'i sjell përfitim pasuror të kundërligjshëm, ka detyruar të dëmtuarën që të veprojë në dëm të pasurisë së saj, duke iu kanosur seriozisht se do ta vrasë, me ç' rast i ka kërkuar shumën prej 500€, ku e njëjta nga frika se do t'i ndodhë diçka e keqe ka qenë e detyruar që t'ia jap shumën prej 500€. Gjithashtu gjykata vlerësuar në aspektin juridik gjeti se në veprimet e të akuzuarit manifestohen elementet objektive dhe subjektive të veprës penale lëndim i lehtë trupor nga neni 188 par.1 të KPK-së të pikës II të këtij aktgjykimi ku i akuzuari me datë 24.09.2013 rreth orës 21.00 në ëmbëltoren "....." në Ferizaj, pas një mosmarrëveshjeje me të dëmtuarën V.SH. i cili kishte kërkuar të holla nga ajo por ajo nuk ia kishte dhënë, ku e kishte kapur për fyti dhe e kishte goditur me grusht në hundë duke i shkaktuar lëndime të lehta trupore dhe atë ndrydhje (mbretje) e indeve të buta të regjionit muror të kokës dhe shuplakës së dorës, e të cilat lëndime rezultojnë me pasoja të përkohshme për shëndetin.

Me rastin e matjes së llojit dhe lartësisë së dënimit gjykata pati parasysh të gjitha rrethanat të cilat ndikojnë në llojin dhe lartësinë e dënimit nenit 64 të KPPK-së, si rrethana lehtësuese gjykata mori gjendjen e varfër të pandehurit, i pa punë, si dhe rrethanat e tij familjare, i njëjti është i martuar, ndërsa rrethana rënduese gjykata gjeti se i njëjti është i njohur dhe recidivist i njëjti edhe më parë ka qenë i dënuar me aktgjykime të formës së prerë ndaj të njëjtës së dëmtuar.¹ Në bazë të këtyre rrethanave gjykata i caktoj dënim si në dispozitiv të aktgjykimit, duke qenë e bindur se një dënim i tillë është plotësisht i justifikueshëm dhe në proporcion me peshën e veprës konkrete penale, rrethanave të kryerjes si dhe personalitetit e të pandehurit, dhe se me këtë dënim do të arrihet qëllimi ndëshkimor në kuptim të preventivës speciale që i pandehuri në të ardhmen të mos kryejë vepra penale, si dhe në kuptim të preventivës së përgjithshme të parandalimit të përgjithshëm të kësaj veprë penale në shoqëri.

E dëmtuara V.SH., për realizimin e kërkesës pasurore Juridike udhëzohet në kontest civil

Obligohet i pandehuri që në emër të shpenzimeve të procedurës penale për ekspertizën mjeko ligjore të paguaj shumën prej 20€ si dhe në emër të paushallit gjyqësor shumën prej 30 €, në afat prej 30 ditëve, nga dita e plotfuqishmërisë së aktgjykimit nën kërcënimin e përmbartimit me dhunë.

¹ Shih aktgjykimin e Gjykatës Themelore në Ferizaj P.nr.420/12 i dt.26.02.2016, Aktgjykimin e Gjykatës Themelore në Ferizaj P.nr.1390/13 i dt.04.11.2013

Nga arsyet e cekura më lartë është vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi

**GJYKATA THEMELORE NË FERIZAJ,
P.nr.216/13 të dt. 09.08.2016**

Sek.juridike
Albana Ajvazi

Gj y q t a r i
Mustaf Tahiri

KËSHILLA JURIDIKE – kundër këtij aktgjykimi është e lejuar ankesa në afat prej 15 ditësh pas pranimit të këtij aktgjykimi, Gjykatës së Apelit në Prishtinë nëpërmjet kësaj gjykate.